



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.30/2018

Prishtinë, më 17 shtator 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Sasha Milosavljeviç, Mexhide Mjaku-Topalli, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Syla, Teuta Haxhiu dhe Fisnik Ismaili.

Munguan: Mirjeta Kalludra, Saranda Bogujevci, dhe Albulena Balaj- Halimaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Adelina Hasani-KDI, Xhemajl Kuliqi- KDI, Milica Ziviq-RTK2, Sanije Berisha-OSBE, Florian Syla-EO, Valbona Bytyçi-EO, Arta Dehari-LVV.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e komisionit.

Anëtarët e komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e komisionit, andaj komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komisionit FunkSIONAL për sesionin pranveror të vitit 2018;
2. Shqyrtimi i planit të punës të plotësuar të Komisionit FunkSIONAL për sesionin vjeshtor të vitit 2018;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për peticione;
4. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komisionit FunkSIONAL për sesionin pranveror të vitit 2018

Kryetarja, tha se materialet i kemi marrë me kohë dhe kemi në shqyrtim raportin e punës për sesionin pranveror 2018 dhe i bëri një elaborim këtij raporti.

Ajo tha se komisioni ka proceduar për lexim të dytë në Kuvend, Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë, po ashtu ka proceduar për lexim të parë në Kuvend, Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës. Po ashtu, në komision, sot e kemi për shqyrtim në parim Projektligjin për petitionet.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është një raport i përgatitur mirë, por propozoi që raporti të plotësohet me takimin me Agjencinë për Barazi Gjinore.

Ajo u interesua të dijë a mund ta kemi raportin vlerësues nga KDI, që ta shohim sesi jemi vlerësuar si komision dhe a është një raport real dhe si duhet të veprojmë në të ardhmen.

Teuta Haxhiu, tha se është me interes që të pasqyrohen rezultatet e takimeve në raport, sepse dihet se janë mbajtur ato takime dhe aktivitete, por të dihen edhe produktet e takimeve, dhe për sesionin vjeshtor, është mirë të detajohen këto takime.

Ajo, më pas foli edhe lidhur me brengat që kanë të bëjnë me punët në Komplexin Memorial në Mejë të Gjakovës dhe kërkoi që të caktohet një datë, që të bëjmë një vizitë në Mejë.

Më tutje, theksoi se kërkon nga administrata që të nxjerrin diskutimin e përfaqësuesve të Shoqatës “27 Prilli”, kur ishin prezent në komision dhe ne të dalim me një përfundim, si komision.

Lirije Kajtazi, tha se për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore është me rëndësi të presim përfundimin e raportit të monitorimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe pastaj të shohim sesi do ta bëjmë dinamikën e punës për këtë çështje.

Në vazhdim, kryetarja hodhi në votim Raportin e punës së Komisionit FunkSIONAL për sesionin pranveror të vitit 2018.

Kryetarja konstatoi se Komisioni FunkSIONAL miratoi Raportin e punës për sesionin pranveror të vitit 2018.

2. Shqyrtimi i planit të punës të plotësuar të Komisionit FunkSIONAL për sesionin vjeshtor të vitit 2018

Kryetarja, tha se në planin e punës, në muajin shtator, të shtohet vizita në Gjakovë dhe në Komplexin Memorial në Mejë.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se është mirë që, kur t'i bëjmë vizitat nëpër komuna, t'i vizitojmë edhe qendrat për punë sociale dhe familjet që kanë marrë fëmijë në strehim dhe t'i shohim si po kujdesen për ata fëmijë dhe çfarë kushtesh jetësore kanë.

Kryetarja, tha se kjo pikë të vendoset në muajin tetor, si dhe të vizitohen edhe shtëpitë e pleqve.

Teuta Haxhiu, tha se janë 7 qendra dhe janë shtëpitë e komuniteteve dhe personave me aftësi të kufizuara dhe është mirë t'i vizitojmë këto qendra, t'i shohim kushtet e tyre dhe këto]

vizita të fillohen në muajin tetor, sepse këto shtëpi kanë probleme dhe disa kërkesa i kanë paraqitur edhe në IAP.

Luljeta Veselaj -Gutaj, tha ase është dakord me propozimin e deputetes Teuta Haxhiu. Më pas, tha se në Prizren ekziston shtëpia e kujdesit për personat të cilët kanë probleme të shëndetit mendorë, ku ata persona që trajtohen aty, janë të rritur dhe nuk kanë përkujdesje familjare, janë qendra ditore. Kjo shtëpi në Prizren dhe të tjerat, nuk dihet a kanë staf dhe kujdes të mjaftueshëm dhe për këtë është mirë që ti vizitojmë disa prej tyre.

Kryetarja konstatoi se këto dy shtëpi, në Prizren dhe Deçan, të vizitohen për një ditë gjatë muajit tetor.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se në muajin nëntor, të ftohet për raportim në komision, Agjencia për Barazi Gjinore. Ndërsa, lidhur me shënimin e 20 nëntorit – datës së miratimit të Konventës ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, propozoi që në mbledhjet e radhës të mendojmë sesi të realizojmë një aktivitet të tillë, si komision.

Në vazhdim, ajo foli edhe lidhur me shënimin e 3 dhjetorit - Dita e personave me aftësi të kufizuara, të shohim çfarë mund të bëjmë për shënimin e kësaj date, qoftë të mbahet një tryezë me ZQM dhe të shihet sa po respektohen apo po shkelen të drejtat e këtyre personave.

Kryetarja, tha se edhe këto dy aktivitete të hyjnë në muajin nëntor.

Në fund të kësaj pike të rendit të ditës, kryetarja konstatoi se komisioni, me këto plotësime, miratoi planin e punës për sesionin vjeshtor të vitit 2018.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për peticione

Kryetarja, tha se ky projektligj është i një rëndësie mjaft të madhe për shqyrtimin e peticioneve. Materialin e keni marrë me kohë dhe besoj se do të arrijmë të kemi një punë të mirë.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se mandatin e kaluar kemi hartuar një udhëzues për peticione dhe ka qenë i gatshëm për miratim, por për shkak të përfundimit të mandatit, kjo punë ka mbetur dhe do të ishte mirë ta analizojmë atë udhëzues dhe këtë projektligj që e kemi tani. Besoj se do të bëhet më e mira e mundshme për shqyrtimin e peticioneve, që dërgohen nga qytetarët.

Lirije Kajtazi, tha se është një projektligj më se i domosdoshëm, për të cilin kemi pasur nevojë edhe më herët. Është mirë që të shikohet edhe udhëzuesi, të cilin e kemi punuar më

herët, sepse diçka mund të bëhet pjesë e amendamenteve në këtë projektligj. Nga deklarata financiare, thuhet se projektligji nuk do të ketë implikime buxhetore, ndërkaq në nenet e caktuara të projektligjit, shihet se ka dhe kjo duhet të shihet me kujdes.

Teuta Haxhiu, tha se është mirë që për herë të parë po diskutojmë për një projektligj të tillë, mirëpo kur kemi hartuar udhëzuesin, në legjislaturën e kaluar, ka pasur më shumë material sesa

vetë ky projektligj. Gjithçka që ka qenë aty, ka qenë në detaje dhe shumë saktë dhe ka qenë sikur projektligj, andaj komplet mund të inkorporohet dhe të bëhet një projektligj i komisionit, ngase komisioni e ka atë lëndë të mandatit të kaluar, që nuk është proceduar. Nisma është shumë e mirë, por të marrim atë udhëzues, ta përpunojmë dhe ta procedojmë si projektligj dhe mos të bëjmë punë të parcializuar.

Kryetarja, tha se sot, ne duhet të rekomandojmë për miratim në seancë plenare dhe pastaj kemi edhe një bazë, në komision do të japim kontributin që të kemi një ligj, ashtu siç duhet të jetë.

Pas një debati në komision dhe kërkesës së disa anëtarëve të komisionit, që të kenë më shumë kohë të analizohet materiali, u vendos që kjo pikë të vendoset për shqyrtim edhe në mbledhjen e radhës së komisionit, si dhe të konsultohemi me zyrën ligjore të Kuvendit.

Shemsi Syla, theksoi se qëndrimi i tij është që projektligji të procedohet për seancë plenare, në këtë mbledhje të komisionit.

4. Të ndryshme

Lujeta Veselaj-Gutaj, tha se ka një vërejtje për Drejtorinë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun të Kuvendit, lidhur me dëgjimin publik për monitorimin e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, të mbajtur në muajin korrik 2018, ndërsa njoftimi në ueb faqen e Kuvendit, përveçse ka dalë me vonesë, ka dalë vetëm në gjuhën serbe. Pra, për mua është shumë shqetësuese, përderisa askush nuk ka qenë prezent nga deputetë të komunitetit serb. Kjo është shumë shqetësuese dhe nuk është përmirësuar as pas vërejtjeve që i kam bërë, sepse e kam përcjellë edhe mbas një jave dhe njoftimi ka qenë vetëm në gjuhën serbe.

Shemsi Syla, kërkoi që si Komision për të Drejtat e Njeriut, të bëjmë një reagim për publikimin e listave të veteranëve mashtrues. Kjo është një shkelje e privatësisë dhe për këtë duhet të reagojmë, sepse kjo ka shkaktuar një gjendje të rëndë tek ata njerëz, të cilët i kanë emrat në ato lista, për të cilët thuhet se janë keqpërdorues, nuk di kush qëndron prapa kësaj dhe kujt i konvenon kjo. Ne të kërkojmë llogari nga organet kompetente.

Komisioni vendosi që të bëjë një reagim lidhur me këtë çështje dhe t'ua dërgojë mediave përkatëse, në emër të komisionit.

Kryetarja konstatoi se komisioni vendosi që më dt. 24 shtator 2018, të vizitojë kryetarin e Komunës së Gjakovës, së bashku me familjarët e Shoqatës “27 Prilli”, si dhe të vizitojë Kompleksin Memorial në Mejë, dhe po atë ditë, në takimet në Komunën e Gjakovës, të bëhet monitorimi i zbatimit të Ligjit për barazi gjinore.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Duda Balje